



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 12 Datë 05. 09. 2017

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “SELCA ENERGJI” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr.2676/5, datë 01.03.2017 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujor të subjektit “SELCA ENERGJI” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes së subjektit “SELCA ENERGJI” sh.p.k. me administrator Z.Sebastian PJETRI, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Vrielit**, degë e Lumit Cemi i Selcës,degë e Lumit Cemi i Bashkuar për prodhim energjie elektrike në Selcë,Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC VRIELA do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes:	X – 43 86 770.6 ;	Y – 47 11 552.2;	Z – + 970 m;
Kaptazhi Nr.1:	X ₁ – 43 86 858.9 ;	Y ₁ – 47 11 751.7;	Z ₁ – +1000 m;
Kaptazhi Nr.2:	X ₂ –43 87 117;	Y ₂ - 47 11 790.1;	Z ₂ - +1000m;
Kaptazhi Nr.3:	X ₃ –43 87 361.7;	Y ₃ - 47 11 869.9;	Z ₃ - +1000m;
Koordinatat e godinës së centrali:	X –43 87 228.6;	Y –47 10 867;	Z - +680 m;
Koordinatat e pikës së shkarkimit :	X –43 87 228.6;	Y –47 10 867;	Z - +680 m;
Prurja mesatare e burimit ujor:	Qmes=0.55m ³ /sek;		
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:	Q llog = 0.84 m ³ /sek;		
Prurja ekologjike:	Q ekol= 0.017 m ³ /sek;		
Prurja që shkarkohet:	Q= 0.84 m ³ /sek		

2-Leja e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Martin PLLUMBI



Kryetar

Paulin RADOVANI